

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 21.01.2023

1. Më poshtë janë pasqyrat e pozitës financiare të dy entiteteve: Austen sh.a dhe Frank sh.a.

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022

	Austen sh.a €'000	Frank sh.a €'000
Pasuritë		
Prona, fabrika dhe paisjet	145,000	80,400
Pasuritë e paprekshme	-	6,400
Investimet në aksione	20,000	-
Pasuritë qarkulluese	<u>104,400</u>	<u>46,800</u>
Total pasuritë	269,400	133,600
Ekuiteti dhe detyrimet		
Aksionet e zakonshme (€2 secila)	75,000	30,000
Fitimet e mbajtura	<u>122,500</u>	<u>53,500</u>
	197,500	83,500
Detyrimet afatgjata	25,000	12,000
Detyrimet afatshkurtëra	<u>46,900</u>	<u>38,100</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	269,400	133,600

Informata shtesë:

- i) Me 1 janar 2022, Austen sh.a bleu 80% të aksioneve të zakonshme në Frank sh.a kur Fitimet e mbajtura të Frank sh.a ishin €45 milionë. Marrëveshja e shitblerjes parashikonte që aksionet të paguheshin si më poshtë:
- Emetim i menjëhershëm i 25 milionë aksioneve preferenciale kumulative me interes prej 15% të Austen sh.a, të emetuara me €3 për aksion. Austen sh.a nuk e ka regjistruar ende këtë konsideratë.
 - Transferimi i menjëhershëm i një parcele toke me vlerë në libra dhe vlerë të drejtë përkatësisht €17 milionë dhe €20 milionë. Austen sh.a ka debituar vetëm "Investime në aksione" dhe ka kredituar "Prona, Fabrika dhe Pajisjet" me vlerën në libra të tokës.
- ii) Në datën e blerjes, vlera në libra e pasurive neto të identifikueshme të Frank sh.a ishte e barabartë me vlerën e tyre të drejtë, përveç dy zërave të mëposhtëm:
- Pasuria e paprekshme (e drejtë ekskluzive e blerë) ka një vlerë të drejtë prej €12 milion dhe vlerë në libra prej €8 milionë. Jeta e saj e mbetur e dobishme u vlerësua në 5 vjet. Shuma e rikuperueshme e së drejtës më 31 dhjetor 2022 u vlerësua në €9 milion. Frank sh.a nuk i ka përfshirë vlerat e drejta në pasqyrat e veta financiare të veçanta. (Injoroni tatimin e shtyrë për këtë rregullim).
 - Një zë pajisjeve ka vlerën e drejtë prej €5 milion më shumë se vlera në libra e tij dhe kishte një jetë të dobishme të mbetur prej 5 vjetësh. Ky rregullim i vlerës së drejtë duhet të konsiderohet si diferencë e përkohshme e cila shkakton tatim prej 20%.

- iii) Frank sh.a. shiti mallra Austen sh.a për €3.2 milionë në nëntor 2022. Austen sh.a mbante gjysmën e këtyre artikujve në stoqet e saj të fundvitit. Frank sh.a. bleu mallrat e shitura në Austen sh.a për €5 milionë nga një furnizues i jashtëm. Në fund të vitit, Frank sh.a. ende i detyrohej furnitorit 40% të kostos së blerjes. Në fund të vitit, Austen sh.a nuk i kishte borxh Frank sh.a në lidhje me transaksionet e mësipërme. Të gjithë artikujt ishin në gjendje të mirë në datën e transferimit. (Injoroni çdo implikim të tatimit të shtyrë).
- iv) Zëri i mirë në Frank sh.a është dëmtuar për 10%. Zëri i mirë vlerësohet duke përdorur metodën e vlerës së drejtë të plotë. Çdo aksion i zakonshëm i Frank sh.a kishte një çmim të drejtë tregu prej €6 në blerje dhe €7.5 në fund të vitit aktual.
- v) Austen sh.a kontabilizon të gjitha investimet pasive në ekuitet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Vlera e drejtë e investimit të Austen sh.a në Frank sh.a ishte €110 milionë më 31 dhjetor 2022.
- vi) Nuk ka pasur lëvizje në kapitalin aksionar të Frank sh.a që nga blerja e tij.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare me 31 dhjetor 2022. (20 pikë)

1.

Grupi Austen**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022**

Pasuritë	€'000
Prona, fabrika dhe paisjet (145,000 + 80,400 + 5,000 - 1,000)	229,400
Pasuritë e paprekshme (6,400 + 4,000 - 600 - 800)	9,000
Investimet tjera (20,000 - 17,000 kostoja e tokës)	3,000
Zëri i mirë (L13)	<u>27,000</u>
	268,400
Pasuritë qarkulluese (104,400 + 46,800 + 900 humbja)	<u>152,100</u>
Total pasuritë	420,500
Ekuiteti dhe detyrimet	
Aksionet e zakonshme	75,000
Fitimet e mbajtura (L15)	<u>128,860</u>
	203,860
Interesi jo-kontrollues (L14)	18,840
Total ekuiteti	222,700
Detyrimet afatgjata (25,000 + 12,000 +75,000 (L13) + 800)	112,800
Detyrimet afatshkurtëra (46,900 + 38,100)	<u>85,000</u>
Total detyrimet	<u>197,800</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	420,500

Llogaritjet (të gjitha në €'000)**1. Struktura e grupit**

Austen sh.a

↓ 80% Interes kontrollues
20% IJK

Frank sh.a

Datat e raportimit 31 dhjetor 2022

Data e blerjes 1 janar 2022

Periudha pas blerjes = 1 vit

2. Neto pasuritë	Data e blerjes	Data e raport.	Pas-blerjes
Frank sh.a			
Aksionet e zakonshme	30,000	30,000	-
Fitimet e mbajtura	45,000	53,500	8,500
Pasuritë e paprekshme (rritja) (12,000 - 8,000)	4,000	4,000	-
Pasuritë e paprekshme (amortizimi) (4,000/5)	-	(800)	(800)
Pasuritë e paprekshme (dëmtimi) -			
- [(12,000 x 4/5) -9,000] ose [(6,400+4,000-800) - 9,000]	-	(600)	(600)
Rritja në vlerën e drejtë të pasurive	5,000	5,000	-
Zhvlerësimi shtesë (5000/5)	-	(1,000)	(1,000)
Tatimi i shtyrë - paisjet	(1,000)	(800)	200
@ blerje (20% x 5,000)			
@ raportim (20% x (5,000 - 1000))			
Humbja e perealizuar (1/2 x (5,000 - 3,200))	-	<u>900</u>	<u>900</u>
	<u>83,000</u>	<u>90,200</u>	<u>7,200</u>

3. Zëri i mirë - Frank sh.a	€'000
Kosto e investimit:	
VD e aksioneve preferenciale të emetuara (25,000 x 3)	75,000
Transferimi i tokës	<u>20,000</u>
	95,000
Shto: VD e IJK-së në blerje (20% x 30,000/2 x 6)	<u>18,000</u>
	113,000
VD e atribuar neto pasurive të blera (L12)	(83,000)
Zëri i mirë në blerje	30,000
Minus: Dëmtimi (10% x 30,000)	<u>(3,000)</u>
Zëri mirë në datën e raportimit	27,000
4. Interesi jo-kontrollues	€'000
VD e IJK në blerje (L13)	18,000
Shto: IJK % në Frank sh.a pas blerjes (20% x 7,200)	1,440
Minus: Dëmtimi i zërit të mirë (20% x 3,000)	<u>(600)</u>
Në datën e raportimit	18,840
5. Fitimet e mbajtura	€'000
Austen sh.a	
Saldo në fillim	122,500
Përfitimi në transferimin e tokës - Frank sh.a (20,000 - 17,000)	3,000
Frank sh.a	
Pjesa e prindit e fitimeve pas blerjes (80% x 7,200)	5,760
Humbja nga dëmtimi - zëri i mirë (80% x 3,000)	<u>(2,400)</u>
Në datën e raportimit	128,860

2. Curie sh.a është një prodhues kemikalesh dhe ka fabrika prodhuese në shumicën e rajoneve. Bilanci i mëposhtëm vertetues lidhet me Curie sh.a. më 31 dhjetor 2022.

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Aksionet e zakonshme prej 50 cent secila		35,000
Premia e aksioneve		82,100
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2022		72,350
4% note krediti (shënimi vii)		22,500
Të ardhurat nga investimet		2,700
Të ardhurat (shënimi iv)		475,350
Kostot e shpërndarjes	77,100	
Shpenzimet administrative	91,150	
Blerjet	250,350	
Interesi i notes kreditore dhe dividenda e përkohshme e paguar	3,000	
Toka dhe ndërtesa sipas kostos (përfshirë €9m për tokën) (shënim i)	57,000	
Toka dhe ndërtesa: zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2022 (shënim iii)		9,600
Fabrika dhe paisjet sipas kostos (shënim ii)	38,500	
Fabrika dhe paisjet: zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2022 (shënim iii)		18,900
Stoqet me 1 janar 2022	66,600	
Tatimi i shtyrë (shënim viii)		10,800
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	110,750	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		43,050
Banka		9,850
Pasuritë financiare (shënim vi)	<u>87,750</u>	<u> </u>
	782,200	782,200

Shënimët në vijim janë të rëndësishme:

- i) Toka dhe ndërtesat të blera para 10 viteve u rivlerësuan për herë të parë më 1 janar 2022 në €113.4 milionë (me €15 milionë ishte në lidhje me tokën). Curie sh.a nuk bën asnjë transferim të fitimet e mbajtura të ndonjë teprice rivlerësimi.
- ii) Një pjesë e fabrikës me vlerë kontabël neto prej €3.6 milionë është testuar për dëmtim më 31 dhjetor 2022 (pas ngarkimit të zhvlerësimit). Rezultatet e konfirmuan se vlera e drejtë minus kostot e shitjes ishte €2.55 milionë. Në të njëjtën datë, kjo pasuri pritej të gjeneronte të ardhura vjetore neto prej €0.6 milionë për pesë (5) vitet e ardhshme, dhe pas kësaj periudhe pasuria do të shitej për €0.63 milionë. Një normë e përshtatshme skontimi për Curie sh.a. është 14%. Faktorët e skontimit për pesë (5) vjet në 14% janë:

Faktori i i vlerës së tanishme

0.519

Faktori kumulativ i vlerës së tanishme

3.433

- iii) Zhvlerësimi i fabrikës dhe pajisjeve që do të përfshihet në kosto të shitjes dhe i ndërtesave në kosto administrative. Zhvlerësimi i pasurive afatgjata do të bëhet si më poshtë:
- Ndërtesat në bazë lineare përgjatë 50 viteve nga data e blerjes.
 - Fabrika dhe pajisjet 20% me metodën e saldës së zbritur
- iv) Në të ardhurat janë përfshirë €58.5 milion shitje në para të kryera nga Curie sh.a ndërsa vepronte si agjent për Franklin sh.a. Marrëveshja e parashikon 10% të shitjeve si komision për Curie sh.a. Deri më 31 dhjetor 2022, Curie sh.a i kishte paguar Franklin sh.a-së €52.65 milionë të cilat janë përfshirë tek blerjet.
- v) Stoqet në fund me 31 dhjetor 2022 janë vlerësuar në €55.5 milionë.
- vi) Pasuria financiare është një instrument ekuiteti, vlera e drejtë e të cilit ishte €90.75 milionë më 31 dhjetor 2022. Nuk ka pasur blerje apo shitje të asnjë prej këtyre investimeve gjatë vitit. Instrumentet e ekuitetit mbahen për tregtim.
- vii) Curie sh.a emtoi notë krediti 4% më 1 janar 2022 në vlerën e tyre nominale prej €22.5 milionë. Nota e kreditit është e riblesueshme (ripagueshme) me një prim në maturim në vitin 2025 dhe kanë një normë efektive të interesit prej 8%.
- viii) Kërkohej një provizion prej €3.75 milionë për tatimin aktual mbi të ardhurat për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022. Gjithashtu, tatimi i shtyrë është rritur në €12.6 milionë më 31 dhjetor 2022.
- ix) Dividentët e përkohshëm prej 3 për qind të vlerës nominale për aksion janë paguar më 1 tetor 2022. Deri më 21 janar 2023 nuk është deklaruar dividenda përfundimtare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022.

Kërkohej:

- (a) Përgatite pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për Curie sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022. (8 pikë)
- (b) Përgatite pasqyrën e pozitës financiare për Curie sh.a me 31 dhjetor 2022. (12 pikë)

Total: (20 pikë)

a) **Curie sh.a**
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

	€'000
Të hyrat (475,350-52,650 (L11))	422,700
Kosto e shitjes (L13)	<u>(213,770)</u>
Fitimi bruto	208,930
Të ardhurat nga investimet	2,700
Përfitimet nga vlera e drejtë e pasurive financiare	3,000
Shpenzimet administrative (L13)	(93,610)
Kostot e shpërndarjes (L13)	<u>(77,100)</u>
Fitimi operativ	43,920
Kosto financiare (L15)	<u>(1,800)</u>
Fitimi para tatimit	42,120
Shpenzimet e tatimit në fitim (L17)	<u>(5,550)</u>
Fitimi për vitin	36,570
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Përfitimet në rivlerësimin e pronës (L12)	<u>66,000</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	102,570

b) **Curie sh.a**
Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022

	€'000
Pasuritë:	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (L12)	125,570
Pasuritë financiare (L14)	<u>90,750</u>
Total pasuritë jo-qarkulluese	216,320
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	55,500
Të arkëtueshmet tregtare	<u>110,750</u>
Total pasuritë qarkulluese	<u>166,250</u>
Total pasuritë	382,570
Ekuiteti dhe detyrimet:	
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	35,000
Premia e askioneve	82,100
Fitimet e mbajtura (72,350 + 36,570 - 2,100)	106,820
Tëprica e rivlerësimit	<u>66,000</u>
Total ekuiteti	289,920

<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Notë krediti 4% (L15)	23,400
Detyrim i tatimit të shtyrë	<u>12,600</u>
Total detyrimet afatgjata	36,000
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>	
Të pagueshmet tregtare	43,050
Tatimi në fitim i pagueshëm	3,750
Mbitërheqja bankare	<u>9,850</u>
Total detyrimet afatshkurtra	<u>56,650</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	382,570

Llogaritjet:

1. Të hyrat

Komisioni i arkëtueshëm (10% * €58,500) = 5,850

Shumat e anuluar me këtë hyrje të dysfishtë:

Debi	Të hyrat	52,650	
Kredi	Kosto e shitjes		52,650

2. Prona, fabrika dhe paisjet

	Toka	Ndërtesa	Fabrika
	€'000	€'000	€'000
Kosto me 1 janar 2022	9,000	48,000	38,500
Minus zhv. i akm me 1 janar 2022	<u>-</u>	<u>(9,600)</u>	<u>(18,900)</u>
VL me 1 janar 2022	9,000	38,400	19,600
Rezerva e rivlerësimit	<u>6,000</u>	<u>60,000</u>	<u>-</u>
Rivlerësuar me 1 janar 2022	15,000	98,400	19,600
Shpenzimet e zhvlerësimit*	<u>-</u>	<u>(2,460)</u>	<u>(3,920)</u>
VL me 31 dhjetor 2022	15,000	95,940	15,680
Humbja nga dëmtimi i fabrikës**	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>(1,050)</u>
VL me 31 dhjetor 2022	15,000	95,940	14,630

Total PFP = 125,570 (15,000+95,940+14,630)

*Zhvlerësimi: Ndërtesat= 98,400/40 vite të mbetura = 2,460

Fabrika = 20% * 19,600 = 3,920

** Humbja nga dëmtimi i fabrikës:

Vlera bartëse e fabrikës	3,600
Shuma e rikuperueshme e fabrikës (më poshtë)	<u>2,550</u>
Humbja nga dëmtimi	1,050
Vlera e drejtë minus kosto e shitjes	2,550

Vlera në përdorim 2,387 [(600 x 3.433)+(630 x 0.519)]

Prandaj, vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim bëhet shumë e rikuperueshme e cila është më e ulët se vlera bartëse e fabrikës, prandaj fabrika është dëmtuar për €1,050

3. Shpenzimet operative

	Kosto e shitjes €'000	Shpërndarjes €'000	Administrative €'000
Sipas bilancit provues	-	77,100	91,150
Stoqet në fillim	66,600		
Blerjet	250,350		
Stoqet në fund	(55,500)		
Humbjet nga dëmtimi	1,050		
Shitjet si agjent (L11)	(52,650)		
Zhvlerësimi:			
Fabrika	3,920		
Ndërtesa			2,460
TOTAL	213,770	77,100	93,610

4. Pasuritë financiare

	€'000
Vlera e drejtë sipas bilencit vertetues	87,750
Përfitimi nga vlera e drejtë	<u>3,000</u>
Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2022	90,750

5. 4% notë krediti

	Saldo fillim €'000	Interesi efektiv @8% €'000	Interesi nominal @4% €'000	Saldo fund €'000
Me 31 dhjetor 2022	22,500	1,800	(900)	23,400

6. Dividenda e paguar

€0.03 x (€35,000,000/€0.50) = €2,100

7. Tatimi i pagueshëm

	€'000
Tatimi aktual i pagueshëm	3,750
Plus rritja në tatimin e shtyrë:(12,600-10,800)	<u>1,800</u>
Ngarkesa në F/H	5,550

3. Pasqyrat financiare në vijim janë të Pankhurst sh.a.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022	€'000
Të hyrat	11,480
Kosto e shitjes	<u>(9,680)</u>
Fitimi bruto	1,800
Të ardhurat nga përfitimet në pronën investuese	120
Kostot e shpërndarjes	(240)
Shpenzimet administrative (shënim (ii))	(700)
Kosto financiare	<u>(100)</u>
Fitimi para tatimit	880
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(320)</u>
Fitimi për vitin	560
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Përfitimet në rivlerësimin e pronës	<u>200</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	760

Pasqyra e pozitës financiare me

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Pasuritë	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese (shënim (i))</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	6,130	4,440
Prona investuese	<u>840</u>	<u>800</u>
	6,970	5,240
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	2,420	1,620
Të arkëtueshmet tregtare	960	1,080
Pasuri e tatimit të shtyrë	-	100
Banka	<u>20</u>	-
	<u>3,400</u>	<u>2,800</u>
Total pasuritë	10,370	8,040
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €0.40 secila (shënim (ii))	2,000	1,200
Premia e aksioneve	1,200	-
Rezerva e rivlerësimit	20	20
Fitimet e mbajtura	<u>2,880</u>	<u>2,620</u>
	6,100	3,840
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Detyrimet ndaj lizingut (shënim (i))	275	350
Granti qeveritar	400	300
Notë krediti 10%	-	800
Detyrim i tatimit të shtyrë	<u>100</u>	<u>60</u>
	775	1,510

<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Të pagueshmet tregtare	2,820	2,100
Mbitërheqja bankare	-	240
Detyrimet ndaj lizingut (shënim (i))	125	150
Granti qeveritar	250	200
Tatimi në fitim i pagueshëm	<u>300</u>	-
	<u>3,495</u>	<u>2,690</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	10,370	8,040

Informatat shitesë në vijim janë të rëndësishme:

- i) Një zë i fabrikës me vlerë bartëse prej €480,000 u shit me një humbje prej €180,000 gjatë vitit. Zhvlerësimi prej €560,000 u ngarkua në pronën, fabrikën dhe pajisjet në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022. Prona dhe pajisjet përfshijnë të drejtën e përdorimit të pasurive të njohura në përputhje me SNRF 16 *Lizingu*. Të gjitha këstet e pagesës së lizingut janë në fund të vitit më 31 dhjetor të çdo viti në përputhje me marrëveshjet e lizingut. Paraja e gatshme e paguar gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022 për të shlyer kryegjënë e detyrimeve të lizingut arriti në €300,000.

Pankhurst sh.a përdor modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 *Prona e Investuese*. Nuk ka pasur blerje apo shitje të pronave investuese gjatë vitit.

- ii) Gjatë vitit ka pasur dy emetime të aksioneve. Një emetim bonus prej 1 për çdo 6 aksione ekzistuese u bë më 1 prill 2022 dhe u financua nga rezerva e rivlerësimit. Një tjetër emetim u bë për para në 1 korrik 2022.
- iii) Gjatë majit 2022, Pankhurst sh.a mori në para një grant nga qeveria në lidhje me blerjen e pajisjeve të prodhimit. Politika e Pankhurst-it është të njohë grantet kapitale si të ardhura gjatë jetës së dobishme ekonomike të pasurive përkatëse. Të ardhurat nga granti në vlerë prej €230,000 u njohën në fitim ose humbje gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e rrjedhës së parasë të Pankhurst sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 në pajtim me SNK 7 *Pasqyra e rrjedhës së parasë*. (20 pikë)

3.

Pankhurst sh.a
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

	€'000
Fitimi para tatimit	880
Kosto financiare	100
Të ardhurat nga përfitimet në pronën investuese	(120)
Zhvlerësimi	560
Të ardhurat nga granti qeveritar	(230)
Humbja në shitjen e fabrikës	180
Rritja ose zvogëlimi në:	
Stoqe (2,420-1,620)	(800)
Të arkëtueshmet tregtare (960-1,080)	120
Të pagueshmet tregtare (2,820-2,100)	<u>720</u>
Rrjedhat e parasë operative	1,410
Refundim i tatimit në fitim (L11)	120
Interesi i paguar (L12)	(100)
Dividenda e paguar (L13)	<u>(300)</u>
Neto rrejdha e parasë nga aktivitetet operative	1,130
 Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese:	
Shitja e fabrikës (480 - 180)	300
Blerja e PFP (L14)	(2,330)
Granti qeveritar i pranuar (L16)	380
Të ardhurat nga prona investuese (L17)	<u>80</u>
	(1,570)
 Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese:	
Emetimi i aksioneve (L18)	1,800
Ripagimi i 10% notave kreditore (0-800)	(800)
Ripagimi i detyrimeve ndaj lizingut	<u>(300)</u>
	700
 Ndryshimet në paranë dhe ekuivalentët e parasë gjatë vitit	260
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	(240)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund	20

Llogaritjet:

L11. Tatimi në fitim i paguar:	€'000
Detyrimet e tatimit në fitim - saldo fillestare (60 - 100)	(40)
Ngarkesa e tatimit në fitim për vitin	<u>320</u>
	280
Tatimi në fitim i arkëtuar (refundim) - saldo balancuese	<u>120</u>
Saldo në fund (100 + 300)	400
L12. Interesi i paguar	€'000
Saldo fillestare	-
Kosto financiare në F/H	<u>100</u>
	100
Interesi i paguar (saldo balancuese)	<u>(100)</u>
Saldo në fund	-
L13. Dividenda e paguar:	€'000
Fitimet e mbajtura - saldo fillestare	2,620
Fitimi për vitin	<u>560</u>
	3,180
Dividenda e paguar (saldo balancuese)	<u>(300)</u>
Saldo në fund	2,880
L14. Paraja e paguar për blerjen e PFP	€'000
PFP - saldo fillestare	4,440
Zhvlerësimi	(560)
Shitjet	(480)
Rivlerësimi	200
Shtimet jo-në para: detyrimet ndaj lizingut të kontraktuara (L15)	<u>200</u>
	3,800
Paraja e paguar për blerjen e PFP (saldo balancuese)	<u>2,330</u>
Saldo në fund	6,130
L15. Shtimet jo-në para: detyrimet ndaj lizingut të kontraktuara	€'000
Detyrimet ndaj lizingut (vetem kryegjëja vetem) - saldo fillestare (350 + 150)	500
Detyrimet e paguara gjatë vitit	<u>(300)</u>
	200
Detyrimet e kontraktuara gjatë vitit (saldo balancuese)	<u>200</u>
Saldo në fund (275 + 125)	400

L16. Grantet qeveritare të pranuara

	€'000
Saldo fillestare (300+200)	500
E ardhura e njohura në F/H gjatë vitit	<u>(230)</u>
	270
Granti i pranuar gjatë vitit (saldo balancuese)	<u>380</u>
Saldo në fund (400+250)	650

L17. Të ardhurat e pranuara nga pronat investuese:

	€'000
Rivlerësimi i pronës investuese (840-800)	40
Të ardhurat nga qiraja (saldo balancuese)	<u>80</u>
Total të ardhurat nga prona investuese në F/H	120

L18. Paraja e pranuar nga emetimi i aksioneve

	Kapitali aksionar	Premia e aksioneve
	€'000	€'000
Saldo në fillim	1,200	0
Emetimi bonus nga rezerva e rivlerësimit 1/6 x 1,200	<u>200</u>	<u>-</u>
	1,400	0
Emetim për para (saldo balancuese)	<u>600</u>	<u>1,200</u>
Saldo në fund	2,000	1,200

Total paraja nga emetimi i aksioneve (600 + 1,200) = 1,800

4.

a) Kapitali aksionar i emetuar i Angelou sh.a, një kompani publike e listuar më 31 dhjetor 2020 ishte €10 milionë. Aksionet e saj janë të denominuara në €10 secila. Fitimet e Angelou sh.a që i atribuohen aksionarëve të zakonshëm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 ishin gjithashtu €10 milionë, duke dhënë fitim për aksion prej €10.

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2021

Më 1 prill 2021, Angelou sh.a emetoi 200,000 aksione të zakonshme me vlerën e plotë të tregut prej €100. Më 1 tetor 2021 u bë një emetim bonus i një aksioni të ri të zakonshëm për çdo katër aksione të zakonshme të mbajtura. Fitimet që u atribuohen aksionarëve të zakonshëm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 ishin €13,800,000

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2022

Më 1 korrik 2022, Angelou sh.a bëri një emetim për të drejta të dy aksioneve të reja të zakonshme me një çmim prej €40 secili për çdo pesë aksione të zakonshme të mbajtura. Oferta u abonua plotësisht. Çmimi i tregut i aksioneve të zakonshme të Angelou sh.a menjëherë përpara ofertës ishte €96 secila. Fitimet që u atribuohen aksionarëve të zakonshëm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 ishin €19,500,000.

Kërkohet:

Llogaritni fitimet për aksion të Angelou sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2022 duke përfshirë shifrat krahasuese. (10 pikë)

b) *Korniza Konceptuale* për raportimin financiar u formulua për të ndihmuar Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në zhvillimin dhe rishikimin e SNRF-ve. Ajo gjithashtu i ndihmon përgatitësit të zhvillojnë politika kontabël konsistente për fushat që nuk mbulohen nga një standard ose ku ka një zgjedhje të politikës së kontabilitetit dhe ndihmon përdoruesit të kuptojnë dhe interpretojnë SNRF-të.

Kërkohet:

Diskutoni prezentimin besnik, rëndësinë dhe krahasueshmërinë si karakteristika kualitative të informatave të dobishëm në marrjen e vendimeve. (10 pikë)

a)

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2021

	2021	2020
FPA bazike = $13,800,000/1,437,500 = €9.6$		= $€10 \times 80/100 = €8$

L1 2021

$1,000,000 \times 3/12 \times 100/80$ fraksioni bonus	312,500
$1,200,000 \times 6/12 \times 100/80$ fraksioni bonus	750,000
$1,500,000 \times 3/12$	<u>375,000</u>
	1,437,500

L12 Çmimi teorik pa të drejtat

	Aksione	për aksion	Vlera
Para	4	€100	€400
Emetimi i të drejtave	<u>1</u>	€0	<u>0</u>
Total	5	€80	400

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2022

	2022	2021
FPA bazike = $19,500,000/1,950,000 = €10$		= $€9.6 \times 80/96 = €8$

L1 2022

$1,500,000 \times 6/12 \times 96/80$ fraksioni bonus	900,000
$2,100,000 \times 6/12$	<u>1,050,000</u>
	1,950,000

L12 Çmimi teorik pa të drejtat

	Aksione	për aksion	Vlera
Para	5	€96	€480
Emetimi i të drejtave	<u>2</u>	€40	<u>€80</u>
Total	7	€80	€560

b) Prezentimi besnik, rëndësia dhe krahasueshmëria

- ✓ Rëndësia: e aftë për të bërë një ndryshim në vendimet e marra nga përdoruesit. Informata e rëndësishme ka vlerë parashikuese, vlerë konfirmuese ose të dyja. Vlera parashikuese u mundëson përdoruesve të vlerësojnë ose vlerësojnë ngjarjet e kaluara, të tashme ose të ardhshme. Vlera konfirmuese i ndihmon përdoruesit të konfirmojnë ose korrigjojnë vlerësimet dhe vlerësimet e kaluara. Informata e rëndësishme jepet gjithashtu në kohën e duhur për të ndikuar në vendimet. Materialiteti ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rëndësinë e informatës. Informata është materiale nëse lënia anash apo keqdeklarimi mund të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të pasqyrave financiare të një entiteti të veçantë raportues.
- ✓ Prezentimi besnik: informtaduhet të përfaqësojë dukuritë që ajo synon të përfaqësojë. Për të qenë një përfaqësim i përsosur besnik, informata duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Komplete - Një përshkrim komplet përfshin të gjitha informatat e nevojshme për një përdorues për të kuptuar dukurinë që po përshkruhet, përfshirë përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme.
- Neutrale - Një përshkrim neutral është pa pasur paragjykim në zgjedhjen apo prezantimin e informatës financiare. Kjo nënkupton që informata nuk duhet të manipulohet në atë mënyrë që të ndikoj vendimet e përdoruesve.
- Pa gabime - Pa gabime nënkupton që nuk ka gabime apo heqje në përshkrimin e dukurisë dhe nuk ka gabime në procesin në të cilin informata financiare është prodhuar. Nuk nënkupton që nuk mund të ketë pasaktësi, veçanërisht kur duhet të përdoren gjykimet.

✓ Krahasueshmëria: Përdoruesit duhet të jenë në gjendje:

- krahasojnë pasqyrat financiare të një entiteti me kalimin e kohës për të identifikuar tendencat në pozitën dhe performancën e saj financiare
- krahasojnë pasqyrat financiare të entiteteve të ndryshme për të vlerësuar performancën e tyre financiare dhe pozitën financiare.

Që kjo të ndodhë duhet të ketë:

- konsistencë dhe
 - shpalosje.
- Një implikim i rëndësishëm i krahasueshmërisë është se përdoruesit janë të informuar për politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, çdo ndryshim në ato politika dhe efektet e këtyre ndryshimeve. Pajtueshmëria me standardet e kontabilitetit, duke përfshirë shpalosjen e politikave kontabël të përdorura nga entiteti, ndihmon në arritjen e krahasueshmërisë.
 - Për shkak se përdoruesit dëshirojnë të krahasojnë pozitën financiare dhe performancën dhe ndryshimet në pozitën financiare të një entiteti me kalimin e kohës, është e rëndësishme që pasqyrat financiare të tregojnë informatat përkatëse për periudhat e mëparshme.

5.

a) Lovelace sh.a filloi një biznes në 1 janar 2022 pa asnjë pasuri jo-qarkulluese, por me para të gatshme prej €10,000. Në 1 janar 2022 bleu stoqe të cilat i paguan plotësisht me para për €10,000, të cilat i shet më vonë, në 30 qershor 2022 për €12,000. Me 30 nëntor 2022 bleu stoqet të tjera me vlerë €15,000 me kredi. Indeksi i nivelit të përgjithshëm të çmimeve jep shifrat e mëposhtme të indeksit.

Data	Indeksi
1 janar 2022	100
30 qershor 2022	105
30 nëntor 2022	120
31 dhjetor 2022	130

Kërkohet:

Llogarisni fitimet (ose humbjet) sipas kontabilitetit të bazuar mbi fuqinë aktuale blerëse për Lovelace sh.a për vitin që mbaron në 31 dhjetor 2022. (5 pikë)

b) Analiza e koeficientëve është një metodë kuantitative për të fituar njohuri mbi likuiditetin, solventitetin, efikasitetin operacional, rentabilitetin dhe kthimin ndaj investitorëve të një kompanie duke studiuar pasqyrat e saj financiare si pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes. Duke pasur parasysh se si politikat e kontabilitetit mund të përdoren për të manipuluar rezultatet e kompanisë kjo na çon drejt disa kufizimeve të analizës së koeficientëve.

Kërkohet:

Diskutoni shkurtimisht disa prej kufizimeve të analizës së koeficientëve. (5 pikë)

c) Më 1 dhjetor 2022, Thatcher sh.a është zotuar për një plan për të shitur një objekt të fabrikës dhe tashmë ka gjetur një blerës potencial për këtë objekt të fabrikës. Thatcher sh.a nuk ka për qëllim të ndërprejë operacionet të cilat kryhen në fabrikë. Më 31 dhjetor 2022 ekziston një numër i porosive të pakryera ndaj blerësve të saj. Thatcher sh.a nuk do të jetë në gjendje ta bart fabrikën tek blerësi para se të ketë ndërprerë plotësisht operacionet në fabrikë dhe të përfundojë të gjitha porositë e pakryera të blerësve të saj. Kjo nuk pritet të ndodhë deri në fillim të prillit 2023.

Kërkohet:

Tregoni duke argumentuar shkurtimisht se a mund të klasifikohet fabrika si 'e mbajtur për shitje' më 31 dhjetor 2022. (5 pikë)

d) Wollstonecraft sh. p. k. kontabilizon një detyrim prej €50,000 për kostot akruale të garancisë për produktet në 31 dhjetor 2022. Kostot e garancisë se produkteve në fjalë nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore derisa Wollstonecraft sh.p.k. të paguajë realisht pretendimet/kërkesat ndaj garancive. Norma e tatimit është 25%.

Kërkohet:

Tregoni ndikimin mbi tatimin e shtyë për Wollstonecraft sh. p. k me 31 dhjetor 2022. (5 pikë)

a)

Qasja që duhet të ndiqet është përgatitja e një pasqyre të të ardhurave sipas kontabilitetit të bazuar mbi fuqinë aktuale blerëse.

	€	€
Të hyrat nga shitja (12,000 x 130/105)		14,857
Minus kostoja e mallit të shitur (10,000 x 130/100)		<u>(13,000)</u>
		1,857
Humbja prej mbajtjes së parasë së gatshme për 6 muaj*	(2,857)	
Fitime prej mbajtjes së të pagueshmeve për 1 muaj**	<u>1,250</u>	
		<u>(1,607)</u>
Fitimi sipas kontabilitetit të bazuar mbi fuqinë aktuale blerëse		250

* (€12,000 x 130/105) - € 12,000 = €2,857

** (€15,000 x 130/120) - € 15,000 = €1,250

Vini re se sipas kontabilitetit të kostove historike fitimi bruto do të kishte qenë €2,000 (€12,000 - €10,000).

b)

- Në vitin e parë të tregtisë së një kompanie nuk do të ketë shifra krahasuese. Pra, nuk do të ketë indikacione nëse koeficienti po përmirësohet ose jo.
- Krahasimi kundrejt mesatareve të industrisë mund të mos jetë edhe aq shpalosëse. Njëbiznes mund t'i nënshtrohet faktorëve që nuk janë të zakonshëm në industri.
- Koeficientët e bazuar në llogaritë e kostos historike u nënshtrohen shtrembërimeve të përshkruara në 1.1 më sipër. Në veçanti, pasuritë e nënvlerësuara do të shtrembërojnë KNKA-në dhe ekzagjerojnë leverazhin.
- Koeficientët ndikohen nga zgjedhja e politikës së kontabilitetit. Për shembull, një kompani që kërkon të mbajë ose të rrisë KNKA -të e saj mund të zgjedhë të mos rivlerësojë pasuritë e saj.
- Pasqyrat financiare u nënshtrohen manipulimit dhe po ashtu edhe koeficientët e bazuar në to. Kontabiliteti kreativ bëhet duke pasur në mendje koeficientët kryesorë.
- Inflacioni gjatë një periudhe do të shtrembërojë rezultatet dhe koeficientët. Fitimi neto dhe në këtë mënyrë edhe KNKA-ja mund të fryhen aty ku përdoret FIFO-ja gjatë një periudhe inflacioni.
- Dy kompani, madhe edhe operuese në të njëjtën industri, nuk mund të kenë të njëjtin profil financiar dhe të rrezikut të biznesit. Për shembull, njëra mund të ketë qasje më të mirë për të ulur çmimin e huamarrjes sesa tjetra dhe në këtë mënyrë është në gjendje të mbajë një nivel më të lartë të leverazhit.

c) Fabrika nuk do të bartet përderisa nuk perfundohen porostië e pakryera të blerësve. Kjo tregon se fabrika nuk është në dispozicion për shitje të menjëhershme në kushtet e saj të tanishme. Fabrika nuk mund të klasifikohet si 'e mbajtur për shitje' më 31 dhjetor 2022. Duhet të trajtohet në të njëjtën mënyrë si zërat tjerë të pronës, fabrikës dhe pajisjeve pra duhet të vazhdohet të zhvlerësohet dhe nuk duhet shpalosur veçmas.

d) Baza tatimore e detyrimit është zero (vlera bartëse prej €50,000 minus shuma e cila do të jetë e zbritshme për qëllime tatimore për sa i takon detyrimit në periudhat e ardhshme).

Kur detyrimi të shlyhet për vlerën e tij bartëse, fitimet e tatueshme të entitetit në të ardhmen do të zvogëlohen me €50,000 dhe njësoj si pagesat e ardhshme të tatimeve më $€ 50,000 \times 25\% = €12,500$.

Diferenca prej €50,000 midis vlerës bartëse (€50,000) dhe bazës tatimore (zero) është një diferencë e përkohshme e zbritshme. Entiteti duhet të njohë në këtë rast një pasuri të tatimit të shtyrë me vlerë $€50,000 \times 25\% = €12,500$ vetëm nëse ka gjasa që entiteti të realizojë fitime të tatueshme në periudhat e ardhshme për të përfituar kështu prej zvogëlimeve në pagesat e tatimeve.